



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2022, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shaban (Idriz) Hoxhës.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika:
 1. Pjesa e parcelës kadastrale nr.1836-0, me sip. 461 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01836-0, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi: P.SH. -rrugët, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Qendër".
 2. Kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesa e parcelës kadastrale nr. 1064-2, Zona kadastrale Matiçan, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-1064-2, në pronësi të: Shaban (Idriz) Hoxhës, me destinim interes i përgjithshëm publik-shfrytëzim publik dhe infrastrukturë rrugore.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Qendër", Planit Rregullues "Kalabria", të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 35-1146, dt. 27.05.2011, si dhe në kuadër të Planit zhvillimor Urban, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 035-181427, dt. 24.09.2013.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/03-177494/22, më 26.07.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit me Vendim për Caktimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr.350/02-71499/21 dt.11.11.2021 ka dhënë pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr.1836-0 Zona Kadastrale Prishtinë , Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-01836-0 në pronësi të : P.SH.Rrugët, me destinim ndërtim me pjesën e parcelës kadastrale nr.1064-2 Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-01064-2 në pronësi të: Shaban (Idriz) Hoxha me destinim interes i përgjithshëm publik sipas Planit Rregullues Prishtina e Re-Zona Qendër.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës së tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit Rregullues Prishtina e Re- Zona Qendër, Planit Rregullues “Kalabria”, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr.35-1146 dt.27.05.2011 si dhe në kuadër të Planit Zhvillimor Urban , të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr.035-181427 dt.24.09.2013, Parcela me nr.1836-0 Zona Kadastrale Prishtinë shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim, dhe infrastrukturë rrugore ndërsa parcela me nr.1064-2 Zona Kadastrale Matican me destinim interes i përgjithshëm publik sipas Planit Rregullues Prishtina e Re- Zona Qendër.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.